

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI  
(TË SHOQËRISË “RIVERSIDE GREEN” SH.P.K)**

Sot, ne date 18/03/2024( dy mije e njezete e kater) me vullnet te lire u hartua kontrata e kalimit te kuotave nepermjet shitjes, midis paleve:

**SHITES:** Shoqëria “MONUMENT REAL ESTATE” Sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M12121046R, me adresë Rruga “She Ahmet Pazari” 3, Zona Kadastrale 8160, përfaqësuar nga Administratori: **Arkond Canaj**, atësia Irfan, amësia Lala, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. personal I906190971.

**BLERES:** Shoqëria **DESARD PARK**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M42713201L, me seli në Ish Kombinati Metalurgjik, ZK 3965 Nr.Pasurise 58, përfaqësuar nga Administratori Eldi Hysolli, atësia Emin, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Zvarisht, Korçë dhe banues në ELBASAN, lindur më 04/01/1988, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033133308 dhe nr. personal I80104096M.

**PARATHENIE :**

*Shoqëria “MONUMENT REAL ESTATE” Sh.p.k si ortak e vetme me 100% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise “RIVERSIDE GREEN” SH.P.K deshiron te shperblej Shoqërine DESARD PARK per bashkepunimin e ngushte ne realizimin e nenshkrimit te Akt Marreveshjes me Nr.Rep 1485, Nr.Kol 870 Date 13/03/2024 dhe Akt Marreveshjes me Nr.Rep 1486 , Nr.Kol 871 Date 13/03/2024 si dhe ne bashkepunime te tjera ne te ardhmen duke qene pjese integrale e kompanise tone.*

**NENI 1**

**OBJEKTI I KONTRATES**

Shitesi, Shoqëria “MONUMENT REAL ESTATE” Sh.p.k, ortak i shoqerise “RIVERSIDE GREEN” shpk, me ane te kesaj kontrate transferon nepermjet shitjes, 1 kuote qe perben 25% te kapitalit themeltar te shoqerise “RIVERSIDE GREEN” SH.P.K, ne favor te pales se interesuar Shoqeria DESARD PARK me vullnet te lire, te plote dhe te sinqerte, ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtarët dhe shoqerite tregtare”, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe Statutit te Shoqerise.

**NENI 2**

**ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS**

Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë është në vlerë monetare 25.000 All [njezete e pesë mije leke), vlere te cilen pala blerese e ka likujduar prane nje banke te nivelit te dyte, shuma sa sipër përbën vlerën e plotë të pjesës së kuotës së shitësit, për të cilën palët kanë rënë dakord.

**NENI 3**

**BAZA LIGJORE**

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;

#### **NENI 4** **GARANCITE**

Shitesi posedon kuotat e lira nga cdo barre siguruese, peng, hipoteke, garanci pagese, barre mbi interesat, kufizim, opsion, pretendim, prokure apo angazhime te tjera te cdo lloj natyre.

Nenshkrimi i kesaj kontrate nga shitesi dhe plotesimi i kushteve te saj nuk perbejne shkelje apo jane ne kundershtrim me normat e (i) statutit te shoqerise, (ii) ndonje gjykim apo urdher, vendim gjyqsor, dekreti apo vendimi te cdo autoriteti vendas apo te huaj subjekt i te cilit eshte shitesi, (iii) ndonje marreveshje, licence apo angazhim ne te cilin keta shites apo shoqeria eshte pale, qe do te cenonte aftesine e tij per te nenshkruar kete kontrate apo per te permbushur detyrimet qe rrjedhin prej saj, (iv) me ligjin e zbatueshem Bleresit deklarone se paraprakisht kane verifikuar gjendjen financiare te shoqerise dhe ka dijeni te plote ne lidhje me detyrimet dhe gjendjen e saj financiare dhe deklarone se njohin dhe pranon te blej kuotat e mesiperme me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe shoqeria ka ne perpjestim me perqindjen e kuotave, duke mos pasur asnje pretendim nga shitesit per periudhen qe ka qene ortak tani dhe ne te ardhmen.

Pas realizimit te ketij transferimi nepermjet shitjes se kuotave me nenshkrimin e ketij akti dhe regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit ortak te shoqerise behen :

- 1- Shoqëria “MONUMENT REAL ESTATE” Sh.p.k, zoterues i plote dhe i ligjshem i 1 kuote, qe perben 75% te kapitalit themeltar te shoqerise “RIVERSIDE GREEN” SHPK,
- 2- Shoqëria DESARD PARK , zoterues i plote dhe i ligjshem i 1 kuote, qe perben 25% te kapitalit themeltar te shoqerise “RIVERSIDE GREEN” SHPK,

#### **NENI 5** **ANEKSET E KONTRATËS**

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksa të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë të Ortakëve
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.
- Akt Marreveshjes me Nr.Rep 1485, Nr.Kol 870 Date 13/03/2024
- Akt Marreveshjes me Nr.Rep 1486 , Nr.Kol 871 Date 13/03/2024


#### **NENI 6** **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Palet deklarojne me vullnet te lire e te plote se bien dakort me kushtet sa me sipër dhe e nenshkruajne kontraten me vullnetin e tyre te plote.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, Ne palet e mesiperme deklarojme se do i ruajme, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

#### **PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITES**  
Shoqëria “MONUMENT REAL ESTATE” Sh.p.k  
Administrator  
Arkond Canaj



**BLERES**  
“Shoqëria DESARD PARK” Sh.p.k  
Administrator  
Eldi Hysolli

**DESARD PARK SH.P.K**  
NUIS: M42713201L  
ELBASAN - ALBANIA

